

STANDARDET PROFESIONALE TË VLERËSUESIT TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 1732/1 Prot.

Tiranë, më 11.5. 2021

URDHËR

Nr. 94, datë 11.5. 2021

PËR

**MIRATIMIN E STANDARDEVE PROFESIONALE TË VLERËSUESIT TË
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të shkronjës c, pika 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të shkronjës d, të pikës 5, të kreut III, të Vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP)”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e “Standardeve Profesionale të Vlerësuesit të institucioneve arsimore parauniversitare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI



Grupi i punës:

Dr. Gerti Janaqi

Dr. Teuta Çobaj

Eniana Veli

Majlinda Ucaj

Shemsi Muça

Anastas Kacorri

Ky dokument u hartua falë konsulencës së Tony Richardson, ekspert ndërkombëtar për lidershipin në arsim, vlerësimin, inspektimin dhe teknologjinë në arsim.

Falënderojmë për sugjerimet e vlefshme që kanë dhënë Albana Çelaj (MASR), Fiqiri Çifliku (DPAP), Nikolin Gërmenji (DRAP Korçë), Kadri Ymeraj (DRAP Lezhë), Gazmira Birçaj (DRAP Fier), Frrok Kacorri dhe Maliq Myrto (DRAP Durrës).

Gjithashtu, falënderojmë për përfshirjen në këtë proces të Jonida Lamaj (AADF) dhe stafin e Shkollës së Drejtorëve.

Redaktor gjuhësor: Zija Kurti

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME

1.1. Hyrje	4
1.2. Përse vlejné këto standarde?	4
1.3. Struktura e standardit	5

PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË VLERËSUESIT

2.1. Përshkrimi i detyrave të vlerësuesit	6
2.2. Shkathtësitë e vlerësuesit	6
2.3. Kompetencat profesionale të vlerësuesit	7
2.4. Standardet profesionale të vlerësuesit	9
2.1.1. Standardi 1. Përvoja dhe cilësitë	9
2.1.2. Standardi 2. Njohuritë dhe të kuptuarit profesional	11
2.1.3. Standardi 3. Aftësitë menaxhuese dhe drejtuese	13
2.1.4. Standardi 4. Mbledhja e të dhënave, analizimi dhe gjykimi i tyre	15
2.1.5. Standardi 5. Komunikimi dhe raportimi	17
Referenca	21

PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME

1.1. Hyrje

Standardet profesionale të vlerësuesit¹ të institucioneve arsimore parauniversitare unifikojnë performancën e vlerësuesit, duke vënë theksin në kriteret e rekrutimit dhe zhvillimin profesional të tij në vijimësi, për sigurimin e cilësisë së arsimit parauniversitar.

Standardet përshkruajnë qartësisht njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe kompetencat profesionale që i nevojiten një vlerësuesi të shekullit XXI. Ato synojnë të zhvillojnë dhe të sigurojnë që vlerësuesi zotëron kompetencat profesionale, duke dëshmuar përgjegjshmëri, paanshmëri dhe besueshmëri, në veprimtarinë vlerësuese/inspektuese.

Standardet nuk kanë për synim të “izolojnë” sjelljet e vlerësuesit në një listë kontrolli, por të ndihmojnë në rekrutimin, zhvillimin profesional, mentorimin, vlerësimin dhe vetëvlerësimin për rritjen e performancës e tij.

Standardet profesionale të vlerësuesit të institucioneve arsimore parauniversitare janë hartuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, në bashkëpunim me Shkollën e Drejtorëve, bazuar në kërkime bashkëkohore kombëtare e ndërkombëtare. Ato përcaktojnë se çfarë duhet të dijë, çfarë shkathtësish duhet të demonstrojë dhe nga ç’ vlera e qëndrime duhet të karakterizohet një specialist në veprimtarinë vlerësuese/inspektuese.

Ndërkohë që arsimi, shkolla dhe shoqëria vazhdojnë të transformohen, standardet profesionale të vlerësuesit mundësojnë që vlerësuesi të përballojë sfidat sot dhe në të ardhmen.

1.2. Përse vlejné këto standarde?

Dokumenti i Standardeve profesionale të vlerësuesit të IAP-ve përshkruan se si specialistët kryejnë monitorimin, kontrollin, vlerësimin dhe inspektimin në institucionet arsimore parauniversitare, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të arsimit parauniversitar dhe dokumentet e vlerësimit të cilësisë së shkollës dhe kopshtit.

¹ “Vlerësues” nënkupton specialistin e institucioneve arsimore, që kryen funksione vlerësuese/inspektuese.

Standardet vlejné:

si parakusht, që specialistët të zhvillojnë vlerësime/inspektime profesionalisht të drejta dhe të besueshme, për të garantuar vlerësimin real të cilësisë së institucioneve arsimore në veçanti dhe të sistemit arsimor parauniversitar në tërësi.

për vlerësimin e performancës së specialistëve në veprimtarinë vlerësuese/inspektuese nga institucionet përgjegjëse. Kompetencat profesionale janë themeli i këtyre Standardeve, të cilat zbërthehen në njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, që demonstrojnë specialistët gjatë veprimtarisë vlerësuese/inspektuese.

për kriteret e rekrutimit të specialistëve të vlerësimit/inspektimit, si dhe i mbështesin ata në identifikimin e nevojave të tyre për zhvillimin profesional në vazhdimësi. Vlerësuesit kanë përgjegjësi të qartë dhe njëkohësisht edhe angazhim të ndërgjegjshëm, për qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit profesional, në mënyrë që të përmirësojnë në vijimësi praktikën vlerësuese/inspektuese.

për vlerësuesit me përvojë, në mënyrë që ata të sigurojnë ndikim të besueshëm, të qëndrueshëm dhe pozitiv të specialistët e rinj, duke modeluar dhe promovuar tek ata veprimtaritë vlerësuese/inspektuese më të mira. Në të njëjtën kohë, ata janë burim frymëzimi edhe për mësuesit e drejtuesit e IAP-ve, për progresin e arritjeve dhe mirëqenien e fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar.

1.3. Struktura e standardit

Standardet profesionale të vlerësuesit të institucioneve të arsimit parauniversitar harmonizojnë përvojën dhe cilësitë, njohuritë dhe të kuptuarit, aftësitë dhe shkathtësitë, si dhe qëndrimet dhe vlerat profesionale gjatë procesit të vlerësimit/inspektimit.

Struktura e standardit përmban titullin dhe përshkrimin e përmblëdhur të tij. Standardi zbërthehet në disa aspekte, që e përcaktojnë dhe e sqarojnë standardin, në mënyrë që të mund të zhvillohet

më tej si udhërrëfyes për vlerësimin/inspektimin dhe njëkohësisht zotërimin e kompetencave profesionale të një vlerësuesi efektiv.

PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË VLERËSUESIT

2.1. Përshkrimi i detyrave të vlerësuesit

Qëllimi kryesor i vlerësuesit të institucioneve të arsimit parauniversitar është të vlerësojë/inspektojë IAP-të, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe dokumentet e vlerësimit të cilësisë së shkollës dhe kopshtit.

Nëpërmjet veprimtarisë së tyre vlerësuese/inspektuese, specialistët mbledhin si prova cilësore, ashtu edhe sasiore, rreth performancës së IAP-ve dhe sistemit në tërësi. Ata i përdorin këto prova, për të ndihmuar shkollat/kopshtet, në përmirësimin e cilësisë së tyre. Raportet e vlerësimit/inspektimit sigurojnë informacion për prindërit, se sa të mira janë institucionet arsimore që ndjekin fëmijët e tyre.

Vlerësuesit informojnë ministrinë përgjegjëse të arsimit mbi cilësinë, pikat e forta dhe të pikave që kanë nevojë për ndryshim të IAP-ve, si dhe japin këshilla mbi hapat që duhen ndërmarrë, për përmirësimin e performancës së sistemit parauniversitar në tërësi. Gjithashtu, ata identifikojnë dhe shpërndajnë praktikatat e suksesshme me anë të konferencave dhe publikimeve.

2.2. Shkathtësitë e vlerësuesit

Shkathtësitë e vlerësuesit janë të nevojshme dhe të domosdoshme, për të qenë efektiv gjatë veprimtarive vlerësuese/inspektuese. Këto shkathtësi i sigurojnë vlerësuesit profesionalizëm, qëndrueshmëri, transparencë dhe integritet.

Më poshtë përshkruhen shkathtësitë e vlerësuesit:

Zbatimi i legjislacionit

Kodi i etikës

Kërkimi bazë

Përdorimi i TIK-ut

Zhvillimi personal

Inovacioni dhe të mësuarit

Teknika për mbledhjen e të dhënave

Analizimi i të dhënave sasiore e cilësore

Vlerësimi i rreziqeve

Përdorimi i të dhënave dhe
konfidencialiteti

Evidentimi i veprimtarive të paligjshme

Dokumentimi i të dhënave

Planifikimi i vlerësimit/inspektimit

Procedurat vlerësuese/inspektuese

Hartimi i pyetësorëve/anketave

Shqyrtimi i dokumentacionit

Intervistimi

Menaxhimi i kapaciteteve njerëzore

Menaxhimi/koordinimi i grupeve të
vlerësimit/inspektimit

Vëzhgimi i veprimtarisë mësimore-
edukative

Interpretimi i legjislacionit

Shkrimi raportit

Këshillimi dhe ndikimi

Trajnimi i grupeve të punës të
vlerësuesve

Raporti vjetor


Informimi

Publikimi

2.3. Kompetencat profesionale të vlerësuesit


Në këtë dokument përshkruhen për herë të parë, kompetencat profesionale që duhet të zotërojë një specialist që kryen funksione vlerësuese/inspektuese në institucionet arsimore parauniversitare. Kompetencat profesionale janë një qasje e re konstruktive për rekrutimin, zhvillimin profesional, si dhe pikë referimi për vlerësimin e performancës së specialistit vlerësues. Kriteret e mëparshme, mbi bazën e të cilave specialisti rekrutohej, ishin të kufizuara vetëm në përvojën dhe njohuritë e tij, duke anashkaluar rëndësinë e kompetencave profesionale.

Nga ana tjetër, nuk mund të kërkohej që specialistët e sapo emëruar të kenë shkathtësitë dhe kompetencat profesionale të një vlerësuesi me përvojë. Megjithatë, të gjithë vlerësuesit duhet që brenda vitit të parë të punës, të dëshmojnë se zotërojnë kompetencat profesionale të mëposhtme:



2.4. Standardet profesionale të vlerësuesit

Dokumenti përmban 5 standarde, përkatësisht:



2.4.1. Standardi 1: Përvoja dhe cilësitë

Përshkrimi i standardit:

Vlerësuesi ka arsimimin e përshtatshëm dhe zotëron kompetencat e duhura profesionale, për të qenë efektiv në zbatimin e detyrave të kërkuara.

Vlerësuesit, në mënyrë që të konsiderohen të përshtatshëm për të ndërmarrë vlerësime/inspektime, janë të drejtë, kompetentë dhe efektivë. Ata kanë arsimin e duhur dhe përvojë të suksesshme si mësues, si drejtues ose si specialist në institucionet arsimore në nivel qendror apo rajonal.

Vlerësuesit kanë njohuri, aftësi, shkathtësi dhe përvoja të nevojshme për detyrën, të cilat përfshijnë: njohuri për metodologjitë e vlerësimit; familjaritet me kurrikulën, programet lëndore dhe konceptet; aftësi për të kryer kërkim të gjerë ndërdisiplinor; aftësi për të shkruar në mënyrë analitike, për të gjykuar drejt, me ndjeshmëri dhe qartësi, si dhe për të informuar me gojë; aftësi

të lidhura me teknologjinë e informacionit; njohje të akteve ligjore e nënligjore për fushën e arsimit; dokumentet e vlerësimit të cilësisë së kopshtit dhe shkollës.

Kompetencat profesionale të vlerësuesit, të nevojshme dhe të domosdoshme për të realizuar një vlerësim/inspektim efektiv janë: i përgjegjshëm, i besueshëm, i vendosur, vizionar, udhëheqës, strateg², bashkëpunues, rezultativ, vendimmarrës, nxë vazhdimisht, punon në ekip, zgjidh problemet dhe komunikues.

Vlerësuesit kanë nivel të lartë të përkushtimit ndaj shërbimit arsimor në tërësi, ndaj politikave arsimore për përmirësimin e cilësisë së institucioneve arsimore parauniversitare dhe reformimin e sistemit arsimor, me inteligjencën, energjinë dhe integritetin e tyre. Ata e konsiderojnë qëllimin e vlerësimit/inspektimit, kontribut për përmirësimin e cilësisë së kopshtit/shkollës në veçanti dhe sistemit arsimor parauniversitar në tërësi, si dhe rolin e tyre të rëndësishëm për arritjen e këtij qëllimi.



Për arritjen e këtij standardi, vlerësuesi duhet:

- të ketë të paktën 5 vjet përvojë të suksesshme në mësimdhënie dhe 3 vjet përvojë të suksesshme në drejtimin e kopshtit/shkollës, ose 3 vjet përvojë si specialist në institucionet e arsimit parauniversitar;
- të zotërojë diplomë universitare të nivelit “Master Shkencor” ose të barasvlershme me të në profilin mësuesi/shkenca edukimi;
- të ketë fituar të paktën titullin “Mësues i kualifikuar”, vlerësuar “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”;
- të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së;
- të përdorë efektivisht TIK-un;
- të dëshmojë vlera arsimore bashkëkohore, duke nxitur dhe përkrahur politikat arsimore të qeverisë shqiptare;

² Kjo kompetencë nënkupton të menduarit në mënyrë strategjike.

- të zotërojë kapacitet intelektual (analitik, krijues, praktik) dhe fizik, për të kërkuar dhe për të zbatuar njohuritë, përfshirë këtu edhe zgjidhjen e problemeve;
- të demonstrojë integritet personal dhe profesional (drejtësi, pavarësi, respekt, ndershmëri, empati, transparencë, ruajtje të konfidentalitetit dhe vlera morale e profesionale);
- të mbrojë interesa publike të ligjshëm, të personave fizikë dhe juridikë;
- të reflektojë me mendje të hapur ndaj ndryshimeve;
- të demonstrojë qëndrueshmëri në mënyrë të përgjegjshme, të hapur dhe të sigurtë në lidhje me sfidat;
- të ketë aftësi të mira për të komunikuar dhe për të ndërvepruar në punën në grup, duke u karakterizuar nga përgjegjësia individuale dhe efienca;
- të marrë pjesë aktivisht dhe në mënyrë të përgjegjshme në veprimtaritë për zhvillimin profesional.

2.4.2. Standardi 2: Njohuritë dhe të kuptuarit profesional

Përshkrimi i standardit:

Vlerësuesi njeh dhe interpreton shumë mirë legjislacionin, dokumentet zyrtare të vlerësimit të cilësisë së IAP-ve, Kurrikulën e Arsimit Parauniversitar, risitë pedagogjike bashkëkohore, procesin e mësimdhënies/të të nxënësve dhe vlerësimin e nxënësve në procesin e vlerësimit/inspektimit.

Vlerësuesit kanë njohuri shumë të mira për të gjitha aspektet e drejtimit dhe menaxhimit të shkollës së suksesshme. Ata kanë njohuri të përditësuara për çdo aspekt të kurrikulës, të sistemit të vlerësimit, të metodologjive bashkëkohore, duke kërkuar dhe duke rishikuar literaturën përkatëse, si dhe të ndryshimeve në politikën arsimore.

Vlerësuesit e kuptojnë potencialin e përdorimit të TIK-ut dhe të teknologjisë së re, për ndryshimin e drejtimit, të menaxhimit, të planifikimit strategjik dhe të vlerësimit, për përmirësimin e institucionit arsimor në të gjitha aspektet.

Vlerësuesit kompetentë dhe efektivë, me përvojën e tyre profesionale, janë në gjendje të vlerësojnë saktësisht, cilësinë e mësimdhënies e të nxënimit dhe metodat më të përshtatshme për aspekte të ndryshme të kurrikulës. Ata ndihen të sigurt në vlerësimin e cilësisë së drejtimit dhe të menaxhimit të IAP-ve, duke interpretuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit, bazuar në përvojat e tyre si drejtues të suksesshëm.

Vlerësuesit përkrahin vlerën e vetëpërmirësimit dhe krijojnë mundësi për rritje profesionale me anë të të mësuarit gjatë gjithë karrierës së tyre. Ata kanë një përvojë të konsiderueshme në metodat e monitorimit dhe të vlerësimit, si dhe në studimet për edukimin, duke treguar aftësi dhe gatishmëri për të modifikuar sjelljen, për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre.

Për arritjen e këtij standardi, vlerësuesi duhet:

- të njohë shumë mirë legjislacionin në fuqi, në fushën e arsimit parauniversitar;
- të jetë i përditësuar me të gjitha ndryshimet e sistemit arsimor parauniversitar, si dhe me tendencat në zhvillimin e tij, duke u bazuar edhe në gjetjet kryesore të kërkimeve ndërkombëtare në fushën e edukimit;
- të zotërojë shumë mirë njohuritë për Kurrikulën e Arsimit Parauniversitar, risitë pedagogjike bashkëkohore, procesin e mësimdhënies/të nxënimit, vlerësimin e nxënësve;
- të zotërojë njohuri teorike dhe aftësi praktike shumë të mira, për zbatimin e kurrikulës së lëndës/fushës përkatëse, të lëndëve me zgjedhje, si dhe të kurrikulës me bazë shkolle;
- të ketë njohuri shumë të mira për drejtimin dhe menaxhimin efektiv të një IAP-je të suksesshme (në kombinimin e planifikimit, në organizimin dhe kontrollin e veprimtarive të burimeve njerëzore drejt arritjeve të synuara);
- të ketë njohuri shumë të mira në përdorimin e TIK-ut;
- të ketë njohuri shumë të mira për planifikimin strategjik, zbatimin dhe vlerësimin për përmirësimin e institucionit arsimor;

- të ketë njohuri shumë të mira të teorisë e praktikës në lidhje me pedagogjinë, për kuptimin e zhvillimit të të nxënës dhe të mirëqenies së fëmijëve;
- të njohë dhe të interpretojë shumë mirë dokumentet zyrtare për vlerësimin e cilësisë së institucionit arsimor;
- të zhvillohet profesionalisht, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë profesionale dhe për të përfituar aftësi shumë të mira dëgjuese, vlerësuese e komunikuese.

2.4.3. Standardi 3: Aftësitë drejtuese dhe menaxhuese

Përshkrimi i standardit:

Vlerësuesi planifikon, organizon, drejton dhe menaxhon të gjithë procesin e veprimtarisë vlerësuese/inspektuese, duke përdorur me efektivitet burimet e nevojshme, për të përmbushur qëllimin e vlerësimit/inspektimit, në përputhje me legjislacionin dhe metodologjinë zyrtare të vlerësimit të jashtëm të institucionit arsimor.

Vlerësuesit efektivë janë shumë të mirë në menaxhimin e kapaciteteve njerëzore, të detyrave dhe të kohës. Ata punojnë me sukses në ekip dhe marrin me vullnetin e tyre rolin e drejtuesit, sa herë që nevojitet. Kur drejtojnë një ekip vlerësimi/inspektimi, ata krijojnë mundësi që secili anëtar i ekipit të marrë pjesë në diskutime për dakordësinë e gjykimeve.

Vlerësuesit bashkëpunojnë dhe përkrahin anëtarët e ekipit, duke respektuar individualitetin e secilit. Ata demonstrojnë nivele të larta etike dhe profesionale në dialogun me mësuesit, drejtuesit, nxënësit dhe prindërit.

Vlerësuesit mirë planifikojnë veprimtarinë vlerësuese/inspektuese dhe janë të familjarizuar me metodat për një planifikim të suksesshëm, duke respektuar afatet kohore. Ata janë përdorues shumë të mirë të IT-së, të sistemeve të të dhënave dhe të portalit zyrtar për kryerjen e veprimtarisë vlerësuese/inspektuese online.

Vlerësuesit kryejnë veprimtarinë vlerësuese/inspektuese në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës, duke marrë parasysh kufizimet e brendshme dhe të jashtme, brenda kufijve të arsyeshëm, në mënyrë që të sigurohen se shkollat/kopshtet e zhvillojnë veprimtarinë mësimore-

edukative, të bazuar në të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për garantimin e mirëqenies të të gjithë nxënësve. Vlerësuesit menaxhojnë çështje komplekse me ngarkesë emocionale dhe sfiduese, me maturi dhe fleksibilitet, duke përdorur strategji konstruktive për trajtimin e tyre. Ata demonstrojnë integritet në vendimmarrje.

Për arritjen e këtij standardi, vlerësuesi duhet:

- të jetë i organizuar mirë, duke zbatuar me korrektësi planin e punës së vlerësimit/inspektimit, përveç situatave kur ndryshimi është i justifikuar dhe i autorizuar;
- të ketë kuptim të qartë të qëllimit të vlerësimit/inspektimit, kompleksitetit të procesit të vlerësimit/inspektimit, të roleve të ndryshme që duhet të kryejë në këtë proces dhe çfarë pritjet të arrijë;
- të planifikojë, të organizojë, të drejtojë dhe të kontrollojë me efektivitet burimet e nevojshme të vlerësimit/inspektimit, që objekti i vlerësimit/inspektimit të përmbushet brenda afateve kohore të përcaktuara;
- të ndërtojë raporte bashkëpunuese, inkurajuese në ekip, në lidhje me punën që do të kryejë secili dhe se si do të procedojnë;
- të kontribuojë pozitivisht në diskutime, debate, dialogë dhe mendimmarrje, duke respektuar individualitetin e secilit vlerësues;
- të delegojë dhe të sigurojë cilësi në punën e vlerësuesve të tjerë të ekipit, duke ofruar sfidë dhe mbështetje profesionale brenda ekipit;
- të koordinojë veprimtaritë e planifikuara të vlerësimit/inspektimit me të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në vlerësim/inspektim, për të sjellë në kohë dhe me cilësi informacionet e kërkuara për kryerjen e vlerësimit/inspektimit;
- të përpunojë informacionin dhe të dhënat komplekse, për të realizuar vlerësim korrekt dhe të besueshëm, duke i përkthyer në rekomandime apo masa të nevojshme;

- të jetë i vendosur për kryerjen e veprimtarisë vlerësuese/inspektuese, në përputhje me legjislacionin, duke marrë parasysh kufizimet e brendshme dhe të jashtme, brenda kufijve të arsyeshëm;
- të zgjidhë në mënyrë konstruktive dhe efektive konfliktet;
- të veprojë në mënyrë të qetë, të matur, fleksibël dhe me vetëbesim gjatë veprimtarisë vlerësuese/inspektuese, duke menaxhuar stresin dhe traumat;
- të tregojë respekt reciprok dhe mirësjellje për të gjithë aktorët e komunitetit shkollor, duke dëgjuar dhe vlerësuar mendimet e tyre;
- të përsosë vazhdimisht ekspertizën dhe praktikën vlerësuese, duke identifikuar dhe shkëmbyer përvoja në shërbim të rritjes së cilësisë së institucionit arsimor.

2.4.4. Standardi 4: Mbledhja e të dhënave, analizimi e gjykimi i tyre

Përshkrimi i standardit:

Vlerësuesi siguron integritet dhe besueshmëri gjatë gjithë veprimtarisë vlerësuese/inspektuese dhe jep gjykime të drejta, të bazuara në prova e dëshmi të mjaftueshme, të sakta dhe objektive.

Mbledhja e informacionit dhe e të dhënave nga burime të ndryshme, realizohet në përputhje me objektivat e vlerësimit/inspektimit dhe kjo bazë të dhënash duhet të jetë e mjaftueshme dhe e argumentuar për të arritur në përfundime. Informacioni zgjidhet në mënyrë të tillë, që të adresojë pyetje përkatëse në lidhje me objektivat e vlerësimit/inspektimit, dhe t'u përgjigjet nevojave informative dhe interesave të palëve të interesuara. Procedurat dhe mekanizmat e përdorur për të mbledhur informacion, sigurojnë që ai të jetë i besueshëm dhe i vlefshëm. Vlerësuesit monitorojnë me kujdes veprimet dhe fjalët e tyre, për të mos zbuluar burimin e informacionit, me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit.

Në kryerjen e veprimtarisë vlerësuese/inspektuese, vlerësuesit janë vigjilentë ndaj mashttimeve të mundshme, veprimeve të tjera të paligjshme dhe abuzimeve, duke përcjellë çdo informacion të këtij aktiviteti të eprorët e tyre, për hetim të mundshëm nga organi epror përkatës.

Vlerësuesit e përdorin informacionin e mbledhur, në mënyrë që të zbulojnë nevojat e institucionit arsimor për ta përmirësuar dhe për ta mbështetur atë të zhvillohet. I gjithë dokumentacioni përkatës i gjeneruar, përdoret në mbështetje të gjetjeve/gjykimeve, të përfundimeve, të rekomandimeve dhe të masave (nëse është e nevojshme).

Kompetenca bazë që një vlerësues efektiv demonstroi, është shkathhtësia për të mbledhur prova/dëshmi për cilësinë e shërbimit arsimor të ofruar nga IAP-ja, dhe t'i analizojë ato me kujdes dhe sistematikisht, me qëllim që të bëjë gjykime të drejta, të sigurta e logjike.

Vlerësuesit kompetentë janë ekspertë të edukimit. Ata këshillojnë stafin drejtues dhe mësues, për përshtatjen e duhur të planeve mësimore me kurrikulën, menaxhimin e klasës, disiplinimin pozitiv, sjelljen profesionale dhe etike, metodat pedagogjike bashkëkohore që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënësve, procesin e vlerësimit të nxënësve etj.

Vlerësuesit vlerësojnë/inspektojnë në mënyrë të pavarur, “pa frikë ose favor”, dhe i komunikojnë në mënyrë profesionale gjetjet dhe gjykimet. Kur bëjnë gjykimet e gjetjeve, ata peshojnë shumë mirë provat kontradiktore dhe arrijnë në përfundime, të cilat janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Për arritjen e këtij standardi, vlerësuesi duhet:

- të mbledhë dhe të analizojë informacionet dhe të dhënat sistematike (kontekstin e shkollës), në përputhje me objektin e vlerësimit/inspektimit;
- të vlerësojë cilësinë, rëndësinë, besueshmërinë, vlerën e informacionit dhe rreziqet, kundrejt qëllimit për të cilin nevojitet;
- të mbledhë dëshmi/prova të mjaftueshme dhe bindëse, duke ruajtur privatësinë, për të mbështetur gjetjet e vlerësimit/inspektimit, pa krijuar supozime në vendimet dhe ndershmërinë e personave që i japin ato;

- të mbështesë provat/dëshmitë me dokumentacionin përkatës, në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të pavarur;
- të zhvillojë intervista/pyetësorë në mënyrë profesionale, për të identifikuar saktësisht, kur janë mbledhur prova të mjaftueshme dhe kur nevojiten prova të mëtejshme;
- të përdorë kriteret e vlerësimit në mënyrë të besueshme, për të bërë gjykime të pakundërshtueshme dhe koherente, që janë plotësisht në përputhje me provat;
- të analizojë, të sintetizojë, të gjykojë, të vlerësojë provat komplekse dhe kontradiktore, për të arritur gjykime të drejta, objektive, të bazuara në prova të sigurt, pa u ndikuar nga interesi i tij ose i të tjerëve;
- të marrë në konsideratë këndvështrimet e të tjerëve dhe provat kundërshtuese të mundshme, për të realizuar një analizë të kujdesshme dhe të besueshme;
- të marrë vendime të drejta, bazuar në prova/dëshmi të plotë e të verifikuara, në përputhje të plotë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- të lidhë në mënyrë të përgjegjshme vendimet e marra me pasojat.

2.4.5. Standardi 5: Komunikimi dhe raportimi

Përshkrimi i standardit:

Vlerësuesi komunikon në mënyrë efektive dhe raporton gjetjet, përfundimet, rekomandimet dhe masat, në mënyrë bindëse, duke u bazuar në të dhëna të sakta, të drejta dhe objektive.

Komunikimi me gojë dhe me shkrim është një ndër kompetencat më të rëndësishme të vlerësuesve. Ata komunikojnë me të gjithë aktorët e interesuar për procesin e vlerësimit/inspektimit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë koncepte, të tilla si: objekti i vlerësimit/inspektimit, drejtimit e vlerësimit/inspektimit, metodologjia e vlerësimit/inspektimit, afatet kohore për realizimin e tij, të dhënat që duhen, vendimmarrja dhe procesi i raportimit.

Vlerësuesit përdorin gjykimin e tyre profesional, duke respektuar politikat e institucionit arsimor të vlerësuar/inspektuar, për të përcaktuar formën, përmbajtjen dhe shpeshhtësinë e komunikimit. Ata ndërveprojnë me profesionalizëm dhe respekt, duke nxitur komunikimin e hapur në të gjitha nivelet. Vlerësuesit komunikojnë me mësuesit, në mënyrë që të sigurojnë informacione të hollësishme, të dokumentuara me prova dhe dëshmi nga burime të ndryshme, në lidhje me punën e tyre mësimore, menaxhimin e klasës, zbatimin e programeve, e kurrikulave etj.

Vlerësuesi është në gjendje të komunikojë hapur dhe në mënyrë objektive, gjetjet e tij tek vlerësuesit e tjerë, për dakordësimin e gjykimeve. Ai ofron sfidë profesionale për kolegët e tij dhe justifikon sfidat e tyre, duke i paraqitur gjetjet saktë dhe qartë. Kur japin feedback-un për stafin e institucionit arsimor, Vlerësuesit komunikojnë në mënyrë të qartë, të përmbledhur dhe bindëse, me gjykime të drejta, të sigurtat e logjike, në përputhje me të dhënat cilësore e sasiore të mbledhura gjatë vlerësimit/inspektimit.

Vlerësuesit gjatë feedback-ut demonstrojnë empati dhe respekt profesional, që IAP-ja të reagojë pozitivisht dhe në mënyrë konstruktive, ndaj gjykimeve në veprimtaritë e saj në fushat: drejtimi dhe menaxhimi, mësimdhënia dhe të nxënësve, vlerësimi dhe arritjet e nxënësve, si dhe mirëqenia e sjellja e nxënësve.

Vlerësuesit hartojnë raportin e vlerësimit/inspektimit, duke u mbështetur plotësisht në gjetjet, gjykimet dhe përfundimet e vlerësimit/inspektimit. Raporti i vlerësimit/inspektimit dëshmon që vlerësimi/inspektimi është kryer sipas dokumenteve zyrtare për vlerësimin e cilësisë së institucionit arsimor dhe aktet ligjore e nënligjore. Gjuha e raportimit është e qartë dhe e saktë, e shkruar me terma të kuptueshëm për të gjitha palët e interesuara.

Përfundimet janë gjykime të drejta, të sigurtat e logjike, në lidhje me programin/veprimtarinë e vlerësuar/inspektuar, bazuar në gjetjet e vlerësimit/inspektimit. Rekomandimet hartohen në atë mënyrë që të përcaktojnë saktë, atë që duhet të korrigjohet/përmirësohet ose të arrihet, si dhe afatet kohore për arritjen e tyre. Vlerësuesit tregojnë kujdes që sipas rastit, të ruhet gjithmonë konfidencialiteti i individëve që japin informacion dhe për të cilët jepet informacion, sipas akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

Vlerësuesit publikojnë raporte dhe përvoja të suksesshme nga të cilat mund të mësojnë të gjitha

IAP-të. Vlerësuesit janë në gjendje të hartojnë këshilla/sugjerime për politikat arsimore, duke shkruar raporte që vijnë nga baza e evidencave/provave të vlerësimit/inspektimit të institucioneve arsimore të vlerësuara/inspektuara. Kjo do të përfshijë shkrimin e raporteve për cilësinë e zbatimit të kurrikulës nga institucionet arsimore, në lidhje me kriteret e cilësisë. Vlerësuesit duhet të jenë në gjendje të analizojnë, sintetizojnë dhe përmbledhin gjetjet e vlerësimeve/inspektimeve dhe të nxjerrin rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së përgjithshme në të gjithë sistemin arsimor.

Kur kërkohet, vlerësuesit duhet të jenë në gjendje të kontribuojnë në veprimtarinë e zhvillimit profesional (përfshirë shkrimin e artikujve, pjesëmarrjen dhe prezantimin në konferenca) për drejtuesit e shkollave, mësuesit dhe specialistët e arsimit.

Për arritjen e këtij standardi, vlerësuesi duhet:

- të komunikojë qartë, bindshëm dhe në mënyrë të përmbledhur me gojë dhe me shkrim;
- të përshtatë stilin e komunikimit me gojë dhe me shkrim para audiencës;
- të informojë institucionin arsimor për të drejtat dhe detyrimet e tij, gjatë veprimtarisë vlerësuese/inspektuese dhe për pasojat ligjore të veprimeve apo të mosveprimeve;
- të shprehë tolerancë dhe empati në komunikim;
- të krijojë marrëdhënie të hapur dhe profesionale me të gjithë aktorët e institucionit arsimor, duke ruajtur dhe zbatuar parimet e besueshmërisë, objektivitetit, konfidencialitetit e kompetencës profesionale;
- të sigurojë reagime të qarta dhe konstruktive, të cilat bazohen në mënyrë të vendosur në prova dhe gjykime të shpjeguara bindshëm, duke i ilustruar me përpikëri, me të gjithë punonjësit dhe drejtuesit e institucionit arsimor;
- të komunikojë nëpërmjet teknologjive të informacionit;
- të përdorë në mënyrë efektive platformat online për realizmin e vlerësimit/inspektimit online;

- të këshillojë institucionin arsimor të vlerësuar/inspektuar për parandalimin dhe shmangien e shkeljes së kërkesave ligjore, në mënyrë të thjeshtë, të kuptueshme dhe pa pagesë;
- të drejtojë mbledhjet e ekipit të vlerësimit/inspektimit në mënyrë konstruktive, për të mundësuar ekipin të arrijë gjykime të sakta dhe të pranueshme nga të gjithë;
- të sigurojë që i gjithë stafi i institucionit arsimor të informohet për vendimmarrjen;
- të hartojë raportin e vlerësimit/inspektimit në kohë, në mënyrë të qartë, të saktë, të besueshme, të plotë, të përmbledhur dhe objektive, duke ruajtur konfidencialitetin në të gjitha rastet e parashikuara me ligj;
- të plotësojë instrumentet përkatëse qartë, në mënyrë koherente dhe të pakundërshtueshme, në përputhje me legjislacionin;
- të shkruajë në raport gjetjet dhe gjykimet që kanë të bëjnë me objektin e vlerësimit/inspektimit, duke marrë parasysh kontributet e secilit anëtar të ekipit;
- të hartojë përfundime dhe rekomandime, të cilat janë rrjedhojë logjike e objektit të vlerësimit/inspektimit dhe të bazuara në gjetjet e vlerësimit/inspektimit;
- të raportojë pranë eprorit, për çdo konstatim të shkeljeve ligjore gjatë veprimtarisë vlerësuese/inspektuese;
- të përgjigjet dhe të zgjidhë çdo ankesë të bërë ndaj raportit të vlerësimit/inspektimit;
- të përzgjedhë dhe të përhapë praktikat e suksesshme të institucioneve arsimore parauniversitare në shkallë kombëtare;
- të informojë dhe të raportojë nëpërmjet raporteve të vlerësimit të cilësisë, letrave informuese dhe komunikimit online, ministrinë përgjegjëse për arsimin, institucionet e saj të varësisë, njësitë vendore arsimore dhe njësitë e qeverisjes vendore;
- të kontribuojë në formulimin ose në rishikimin e politikave dhe të strategjive arsimore, si dhe në vendimmarrjet në fushën e reformave arsimore, mbi bazën e gjetjeve dhe informacioneve nga vlerësimet/inspektimet.

REFERENCA

1. Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
4. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
5. Kodi i etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë.
6. VKM nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”.
7. VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.
8. European Commission/EACEA/Eurydice, Assuring Quality in Education: *Policies and Approaches to School Evaluation in Europe. Eurydice Report*, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2015.
9. Ofsted raising standards improving lives: Qualifications, experience and standards required of additional inspectors undertaking inspection on behalf of Her Majesty's Chief Inspector of Education, Children's Services and Skills marrë në gusht 2020, nga https://dera.ioe.ac.uk/16035/1/Qualifications_%20experience%20and%20standards%20required%20of%20additional%20inspectors.pdf.
10. Council of the Inspectors General on Integrity and Efficiency: Quality Standards for Inspection and Evaluation, marrë në gusht 2020, nga <https://www.ignet.gov/sites/default/files/files/committees/inspect-eval/iestds12r.pdf>.
11. Gray A., European school inspection and evaluation: History and principles, 2019, marrë në korrik 2020, nga <http://www.sici-inspectorates.eu/news/understanding-the-development-of-school-inspection>.
12. Kasimati M., Sjellja organizative, 2014.
13. Konopaske, R., Ivancevich, J. And Matteson, M., Organizational Behavior And Management. 11th ed. New York: Mc. Graw Hill Education, 2018, marrë në korrik 2020, nga <https://drive.google.com/file/d/1ngiRzCtdfNM0aeYwV4DWOvgoQ3CAw8lM/view?usp=sharing>

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

 Rruga "Naim Frashëri" Nr. 37, Tirana, Shqipëri

 (+355) 4256440 / 4256441

 sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al

